



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:039205
Datë: 01.03.2024
Numri i dokumentit: 05400626

Pml.nr.142/2024

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale ndaj të pandehurit N. C., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “*Lëndimi i rëndë trupor*”, nga neni 186, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1., dhe 1.3., të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Veton Puka, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, PP.nr.7/2024 të datës 2.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.186/2024 të datës 9.2.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 1.3.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit N. C., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë, PP.nr.7/2024 të datës 2.2.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.186/2024 të datës 9.2.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, me aktvendimin PP.nr.7/2027 të datës 2. 2.2024, të pandehurit N. C., për shkak të veprës penale “Lëndimi i rëndë trupor”, nga neni 186, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., dhe 1.3., të KPRK, të pandehurit V. K. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”, nga neni 185, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. të KPRK, ua ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, e cila masë do t’iu zgjasë nga data 1.2.2024 deri më datën 1.3.2024. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1, dhe 1.2, pika 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PNIDP.nr.186/2024 e datës 9.2.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit N. C. av. Veton Puka, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 - 439 të KPP, me propozim që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara dhe të pandehurit t’i ndërprehet masa e paraburgimit ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.59/2024 të datës 29.2.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. paragrafi 1. lidhur me nenin 436. paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se arsyeja e caktimit të masë së paraburgimit – rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk ekziston sepse edhe të pandehurit edhe familjarët e tyre kanë deklaruar se nuk dëshirojnë konflikt. I pandehuri edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se nga ana e tij nuk ka rrezik për konflikt. Familjarët kanë nënshkruar deklaratë ku kanë pohuar që konflikti ka mbaruar. Dyshimi i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikuleshme dhe se aktvendimi duhet të përfshijë arsyetimin e të gjitha fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar caktimin e paraburgimit. Video incizimi nuk është administruar në mënyrë të ligjshme dhe se mbrojtjes nuk i është dhënë ky incizim. Nuk është arsyetuar mos aplikimi i masave alternative si arresti shtëpiak.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga kallëzimi penal me numër të rastit 2024-DE-044 të datës 2.2.2024, aktvendimit për fillimin e hetimeve, procesverbalet e dëshmitarëve, të pandehurve, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, fotoalbumi, informacionet personale dhe shkresave tjera në lëndë, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri dyshohet se ka kryer veprën penale për të cilën pandehet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në

fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1. e 1.2. të KPP.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e masës së paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.2. pika 1.2.3., të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, karakteristikat personale të të pandehurit, të pandehurit edhe më herët kanë pasur raporte të acaruar me njëri tjetrin – të cilët kanë qenë shokë, janë fqinj por nuk flasin me njëri tjetrin që 12 vite dhe nga atëherë kanë inate në mes vete, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj caktimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Pml.nr.142/2024 me datën 1.3.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala